

# Akt Themelimi

LUSHNJE ME DATE 15 Qershor 2021

I shoqerise tregtare " RESTORANT PESHKU " sh.p.k

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.9723,date 03.05.2007 "per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket:

## formulimi

### Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur " RESTORANT PESHKU " SH.P.K. .

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacioni ku do te kete seline dega.

## Selia e Soqerise

### Neni 2

Selia e shoqerise :

Selia e shoqerise do te jete ne Rruga e Thanasaj, Fshtati Zhame Sektor , zona kadastrale nr 3916 , Numri Pasurise 46/8-Nd 9001, Lushnje .Per qellime te komunikimit elektronik do te jete adresa nderto.as@gmail.com

Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj, te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoj filiale si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te shoqerise.

## Objektimi I Veprimtarise

### Neni 3



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Bar restorant, sherbim katering

## Kohezgjatja e shoqerise

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkak.

## Kapitali I Shoqerise

### Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private " RESTORANT PESHKU " sh.p.k do te jete **10.000**  
(DHJETEMIJE,LEKE)

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakeve te shoqerise , e ndare ne 2 kuota.

Kapitali themeluar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

## Drejtimi I Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj .


Ai ( Administratori) eshte perfaqshues i shoqerise ne mardhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqshues i pajisur me prokure te posacme.

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise.

### Neni 8



Ortakët themelues kanë të drejtë të emerojnë dhe administrojnë të tjerë të vlerave materiale. Kanë të drejtë të caktojnë financiare, likuidator për problemin e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

#### Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën shqiptare, rrethi në varesi të vendit me të afërt të selisë në momentin e lindjes së konfliktit.

#### Neni 10

Shoqëria ka vullnet të saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

#### Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.20018 "për krijimin e shoqërive tregtare", si dhe duke zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

#### Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë"

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht

" RESTORANT PESHKU" sh.p.k

Besmiri Gholja  
Hoxha

Ervin Kokja